



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet në Programin për Hulumtime dhe Publikime

Gusht 2017

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

Aktivitetet e realizuara në PTF– gusht 2017

Akademia e Drejtësisë, në drejtim të përmbushjes së programit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar prokurorët e shtetit të sapoemëruar.

Në kuadër të trajnimit teorik, janë realizuar dy (2) sesione nga nën-moduli “E drejta e BE-së”, ku janë trajtuar Katër Liritë Themelore në Tregun e Brendshëm të Bashkimit Evropian dhe shqyrtimi gjyqësor në Bashkimin Evropian.

Po ashtu, në kuadër të trajnimit teorik, janë realizuar tri (3) sesione nga nën-moduli “Parashkrimi” ku ndër të tjera janë trajtuar edhe këto çështje: kuptimi dhe natyra juridike e parashkrimit; kohëzgjatja për parashkrimin e ndjekjes penale sipas Kodi Penal të Republikës së Kosovës; mosparashkrimi i veprave penale

që kanë të bëjnë me shkelje të rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare; si dhe ndërprerja e parashkrimit për shkak të kryerjes së veprës tjetër penale.

Nga nën-moduli “Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale” përmes tri (3) sesioneve trajnuese, janë trajtuar: dëshmitarët e mbrojtur dhe dëshmitarët bashkëpunues, i dëmtuari dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor. Po ashtu, në kuadër të trajnimit teorik, janë realizuar edhe tri (3) sesione nga nën-moduli “Ushtrimi i mjeteve juridike nga ana e prokurorit” dhe dy (2) sesione nga nën-moduli “Procedurat e veçanta sipas KPPK-së”.

Në kuadër të trajnimit praktik, prokurorët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në prokuroritë përkatëse, me mbështetjen e mentorëve, konform orarit të përcaktuar me program.



Aktivitetet në Programin për Hulumtime dhe Publikime

Publikimi i Doracakut për Shkrimin dhe Arsyetimin ligjor

Me 10 gusht 2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të projektit të USAID-it “Programi për fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në



Kosovë” realizoj ceremoninë e publikimit të Doracakut për Shkrimin dhe Arsyetimin Ligjor.

Të pranishmëve në këtë ceremoni iu drejtuan me një fjalë rasti znj. Luljetë Hetemi, Udhëheqëse e Programit për Hulumtime dhe Publikime në Akademinë e Drejtësisë, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës z. Nehat Idrizi, Drejtori i zyrës së Programeve të USAID-it z. Paul Vaca dhe në emër të autorëve



të këtij publikimi. z. Fejzullah Hasani.

znj. Luljetë Hetemi mes tjerash theksoj “Akademia e Drejtësisë është e përkushtuar edhe më tej në zhvillimin e veprimtarisë botuese për përmbushjen e nevojave të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor, duke qenë se në mandatin e saj ligjor përveç trajnimeve ka edhe veprimtarinë kërkimore dhe botuese me qëllim të zhvillimit të gjyqësisë në Kosovë në pajtim me standardet evropiane”. Më tej në fjalën e saj ajo shprehi



“falënderim për projektin e USAID-it i cili ka mundësuar realizimin e këtij publikimi, autorët që kanë kontribuar në hartimin e doracakut, Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial për bashkëpunimin institucional si dhe gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që japin ekspertizën e tyre në publikimet e Akademisë”

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës falënderoi USAID-in që vazhdon të mbështesë Këshillin Gjyqësor të Kosovës përfshirë edhe Akademinë e Drejtësisë ndërkaq sa i përket doracakut përgëzoi autorët që kanë kontribuar në hartimin e tij dhe njëkohësisht theksoi rëndësinë hartimit dhe shkrimit ligjor në procesin e bërjes së drejtësisë.



Drejtori i zyrës së Programeve të USAID-it z. Paul Vaca, në fjalimin e tij mes tjerash tha “Ky publikim është si rezultat i bashkëpunimit me Akademinë e Drejtësisë duke shprehur falënderim të veçantë njëkohësisht edhe për autorët e këtij doracaku”. Njëherit, i njëjti theksoi se USAID në kuadër të projektit Programi për fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë do vazhdojë edhe më tutje të përkrahë ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të gjyqësorit të Kosovës.

Ndërsa, z. Fejzullah Hasani, në emër të autorëve të këtij doracaku në fjalën e tij

përgëzoi Akademinë e Drejtësisë dhe USAID-in, për këtë publikim, duke rekomanduar gjyqtarët në shfrytëzimin e tij gjatë punës së përditshme jo si shabllon, por si udhërrëfyes gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore.

Në këtë ceremoni morën pjesë, kryetar të gjykatave, gjyqtarë mbikëqyrës, përfaqësues nga Këshilli gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial, stafi i projektit të USAID-it si dhe nga Akademia e Drejtësisë.

<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**